

Ministri Bushati prezanton ecurinë e SEECP-së në AFET.

Bruksel, 5 mars 2015



Më 5 mars 2015, Ministri i Punëve të Jashtme, z. Ditmir Bushati, mori pjesë në takimin e Grupit të Punës për Ballkanin Perëndimor të Komitetit për Çështjet me Jashtë (AFET) në Parlamentin Europian (PE). Ministri Bushati u ftua në këtë takim në cilësinë e Kryetarit të Radhës së SEECP, së bashku me Sekretarin e Përgjithshëm të RCC, z. Goran Svilanovic.

Takimi u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit informal të këtij grupi z. Eduard Kukan, i cili duke e cilësuar programin e Kryesisë Shqiptare të SEECP si ambicioz, vlerësoi në veçanti theksimin që kjo kryesi i ka kushtuar programit ekonomik, sigurisë së energjisë, infrastrukturës dhe interkonjeksionit. Gjithashtu ai u shpreh se sheh ambicie të fortë në luftën kundër terrorizmit dhe çështjes së luftëtarëve të huaj duke përmendur deklaratën e miratuar në takimin e Ministrave të Jashtëm të SEECP, në 24 shkurt 2015, Tiranë.

Ministri Bushati në adresimin e tij, pasi falenderoi eurodeputetët për interesimin ndaj bashkëpunimit rajonal në Evropën Juglindore, vuri në dukje se rritja e vëmendjes së institucioneve të BE-së ndaj problematikave dhe zhvillimeve në Evropën Juglindore, mbetet tepër e rëndësishme për të gjithë vendet e SEECP-së. Ai nënvizoi se motoja e Kryesisë Shqiptare: “Pronësia Rajonale në Veprim”, përpiqet për të kapur thelbin e SEECP si një nisëm pro-aktive në rajon, duke synuar një partneritet gjithnjë e më të ngushtë në Evropën Juglindore në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE.

Z. Bushati vuri në dukje se siguria e procesit të integritimit në BE, është e vetmja mënyrë për të inkurajuar dhe motivuar shoqëritë dhe administratat tona publike. Ai informoi të pranishmit mbi objektivat dhe prioritetet politike të Kryesisë Shqiptare të SEECP si dhe mbi kalendarin e aktiviteteve në fushat kryesore ku do të zhvillohen veprimtari që e konkretizojnë bashkëpunimin rajonal.

Z. Svilanovic, në fjalën e tij u shpreh se sinergjia mes SEECP dhe RCC mbetet shumë e rëndësishme për promovimin e bashkëpunimit rajonal dhe për proceset integruese në BE dhe NATO të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo sinergji, theksoi ai, vazhdon të forcohet edhe gjatë Kryesisë Shqiptare të SEECP-së. Gjatë vitit të fundit progres i rëndësishëm është shënuar brenda SEECP në terma të: gjithëpërfshirjes, forcimit të rolit rajonal dhe rritjes së vizibilitetit mes institucioneve europiane, rritjes së transparencës në bashkëpunim.

Eurodeputetët në diskutimet e tyre vlerësuan takimin dhe informacionet si dhe shprehën një serë idesh me synim forcimin e frymës së bashkëpunimit, përmes rritjes së rolit të SEECP –së rajon.